LIGJ
Nr.9288, datë 7.10.2004

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS "PËR MBROJTJEN E INDIVIDËVE NË LIDHJE ME PËRPUNIMIN AUTOMATIK TË TË DHENAVE PERSONALE"

Ne mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKES SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale", bërë në Strasburg, më 28.1.1981.

Neni 2

Ne përputhje më piken 2/a të nenit 3 të Konventës, Republika e Shqipërisë deklaron se nuk do ta zbatojë këtë Konvente për kategorinë e të dhënave personale:

a) përpunimi i të cilave kryhet vetëm për qëllime individuale nga vetë individët, me kusht që këto të dhëna të mos përdoren për t'u shpërndarë nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit.

b) që disponohen publikisht sipas ligjit, si dhe ato të dhëna, publikimi i të cilave behet më ligj.

Neni 3

Ne përputhje më piken 2/b të nenit 3 të Konventës, Republika e Shqipërisë deklaron së do ta zbatoje këtë konvente për të dhënat, që kane të bëjnë më grupe personash, shoqata, fondacione, shoqëri, institucione dhe ente të tjera, që përbëhen drejtpërsëdrejti ose tërthorazi nga individë, pavarësisht nëse kane ose jo personalitet juridik.

Neni 4

Ne përputhje më paragrafin e dyte të nenit 13 të Konventës, Republika e Shqipërisë deklaron së organet e caktuara për bashkëpunim ndërmjet palëve janë:

Ministria e Drejtësisë, më adrese: Bulevardi "Zogu I", nr.5, Tirane, Shqipëri.

2. Instituti i Statistikave (INSTAT), më adrese: Rruga "Leke Dukagjini", Tirane, Shqipëri.

Neni 5

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur më dekretin nr.4375, date 26.10.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTË
PËR MBROJTJEN E INDIVIDËVE NË LIDHJE MË PËRPUNIMIN AUTOMATIK TË TË DHËNAVE PERSONALE
Strasburg 28.1.1981

Preambulë

Shtetet anëtarë të Këshillit të Europës, nënshkruese,

duke pasur parasysh së Këshilli i Europës është për të arritur një unitet më të madh ndërmjet anëtarëve të tij, bazuar sidomos mbi respektimin e shtetit ligjor, si dhe të drejtat e njeriut dhe lirive themelore,

duke pasur parasysh së është e dëshirueshme të zgjerohen garancitë për të drejtat e të gjithëve dhe liritë themelore, dhe sidomos të drejtat për të respektuar jetën private, duke marrë parasysh fluksin ndërkufitar në rritje të të dhënave personale që i nënshtrohen përpunimit automatik,

duke riafirmuar në të njëjtën kohë përkushtimin e tyre për lirinë e informacionit pavarësisht nga kufijtë,

duke njohur që është e nevojshme të përshtaten vlerat themelore për respektimin e jetës private dhe fluksin e lirë të informacionit ndërmjet njerëzve,

kanë rënë dakord si më poshtë:

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

Qëllimi i kësaj Konvente është të sigurojë në territorin e çdo palë për të gjithë individët, pavarësisht nga shtetësia ose vendbanimi i tyre, respekt për të drejtat e tyre dhe liritë themelore, dhe në veçanti të drejtën e tyre për jetën private, në lidhje më përpunimin automatik të të dhënave personale që kanë të bëjnë më të (mbrojtja e të dhënave).

Neni 2
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) "Të dhënat personale" janë të gjitha informacionet që kanë të bëjnë më një individ të identifikuar ose të identifikueshëm;

b) "Dosje e të dhënave të autorizuara" janë të gjitha kompletet e të dhënave që i nënshtrohen përpunimit automatik.

c) "Përpunimi automatik" përfshin operacionet e mëposhtme, nëse kryhen plotësisht ose pjesërisht më anë të mjeteve automatike: ruajtja e të dhënave, kryerja e veprimeve logjike dhe/ose aritmetike mbi këto të dhëna, ndryshimin, fshirjen, marrjen ose shpërndarjen e tyre;

d) "Kontrollor i dosjes" është çdo person fizik ose juridik, organ publik, agjenci ose ndonjë autoritet tjetër që është kompetent në bazë të ligjit vendas për të vendosur së cili duhet të jetë qëllimi i dosjes së të dhënave të automatizuara, cilat kategori të të dhënave personale duhet të ruhen dhe cilat veprime duhet të zbatohen mbi to.

Neni 3
Fusha e zbatimit

1. Palët marrin përsipër të zbatojnë këtë Konventë për dosjet e të dhënave personale të automatizuara dhe për përpunimin automatik të të dhënave personale në sektorët publikë dhe privatë.

2. Çdo shtet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose anëtarësimit, ose në një datë të mëvonshme, mund të bëjë të ditur nëpërmjet

një deklarate drejtuar Sekretarit të Këshillit të Europës:

a) së ai nuk e zbaton këtë, Konventë për kategori të caktuara të dosjeve për të dhënat personale të automatizuara, duke depozituar edhe një listë të tyre. Megjithatë në këtë listë nuk përfshihen kategoritë e dosjeve për të dhënat e automatizuara që në bazë të ligjit vendas u nënshtrohen dispozitave për mbrojtjen e të dhënave. Ai e ndryshon këtë listë përkatësisht nëpërmjet një deklarate të re, kurdoherë që kategori të tjera të dosjeve për të dhënat personale të automatizuara u nënshtrohen dispozitave për mbrojtjen e të dhënave në bazë të ligjit vendas;

b) së ai e zbaton këtë Konvente për informacionin që ka të bëjë më grupe personash, shoqata, fondacione, kompani, korporata ose institucione të tjera që përbëhen direkt ose indirekt nga individë, pavarësisht nëse këto institucione kanë ose jo personalitet juridik;

c) së ai e zbaton këtë Konventë për dosjet e të dhënave personale, të cilat nuk përpunohen automatikisht.

3. Çdo shtet i cili e ka zgjeruar fushën e zbatimit të kësaj Konvente më anë të deklarimeve të parashikuara në nënparagrafët 2. b ose c të mësipërm mund të bëjnë të ditur në këtë deklarim së këto zgjerime zbatohen vetëm për kategori të caktuara të dosjeve të të dhënave personale, duke depozituar edhe një liste të tyre.

4. Çdo palë, që ka përjashtuar kategori të caktuara të dosjeve për të dhënat personale të automatizuara nëpërmjet një deklarimi të parashikuar në nënparagrafin 2.a të mësipërm, nuk mund të pretendojë zbatimin e kësaj Konvente për këto kategori nga një palë që nuk ka bërë përjashtime të tilla.

5. Po kështu, një palë që nuk ka bërë ndonjë nga zgjerimet e parashikuara në nënparagrafin 2. b dhe c të mësipërm nuk mund të pretendoje zbatimin e kësaj Konvente për këto pika në lidhje më ndonjë palë që i ka bërë këto zgjerime.

6. Deklarimet e parashikuara në paragrafin 2 të mësipërm, bëhen të efektshme që nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në lidhje më shtetin që i ka bërë ata, kur këta janë bërë në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose anëtarësimit, ose tre muaj pas marrjes së tyre nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës, kur këto janë bërë në një datë të mëvonshme. Këto deklarime mund të tërhiqen, plotësisht ose pjesërisht, nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Këto tërheqje hyjnë në fuqi tre muaj pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë.

KAPITULLI II
PARIMET THEMELORE TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE

Neni 4
Detyrat e Palëve

1. Secila palë merr masat e nevojshme në ligjin vendas për të bërë të efektshme parimet themelore për mbrojtjen e të dhënave të paraqitura në këtë kapitull.

2. Këto masa merren jo më vonë së në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në lidhje më palën përkatëse.

Neni 5
Cilësia e të dhënave

Të dhënat personale që i nënshtrohen përpunimit automatik janë:

a) marrë dhe përpunuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme;

b) ruajtur për qëllime specifike dhe të legjitimuara dhe që nuk përdoren në ndonjë mënyrë që nuk përputhen më këto qëllime;

c) të përshtatshme, që përfshihen dhe jo të tepërta në lidhje më qëllimet për të cilat ato janë ruajtur;

d) të sakta dhe, nëse është e nevojshme, mbahen aktuale;

e) mbahen në një formë që i lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave për jo më shumë nga sa kërkohet për qëllimet për të cilat janë ruajtur akoma këto të dhëna.

Neni 6
Kategori specifike të të dhënave

Të dhënat personale që tregojnë origjinën racore, bindjet politike, besimet fetare ose të tjera, si dhe të dhënat personale që kanë të bëjnë më shëndetin ose jetën seksuale, nuk mund të përpunohen automatikisht, përveç kur ligji vendas parashikon garanci të përshtatshme. E njëjta gjë zbatohet për të dhënat personale që kanë të bëjnë më fajësimet penale.

Neni 7
Siguria e të dhënave

Merren masa të përshtatshme sigurie për mbrojtjen e të dhënave personale të ruajtura në dosjet e të dhënave të automatizuara kundër prishjes së tyre aksidentale ose të paautorizuar ose të humbjes aksidentale, si dhe kundër hyrjes, ndryshimit dhe shpërndarjes së paautorizuar.

Neni 8
Garant shtesë për subjektin e të dhënave

Çdo personi i jepet mundësia:

a) të themelojë ekzistencën e një dosjeje më të dhëna personale të automatizuara, qëllimet e saj kryesore, si dhe identitetin dhe vendbanimin e zakonshëm ose vendin kryesor të punës së kontrollit të dosjes;

b) të marrë në intervale të arsyeshme dhe pa vonesë ose shpenzime të mëdha, konfirmimin nëse të dhënat personale që kanë të bëjnë më të janë ruajtur në një dosje më të dhëna të automatizuara, si dhe komunikimin tek ai të këtyre të dhënave në një forme të kuptueshme;

c) të beje, siç mund të jetë rasti, korrigjimin ose fshirjen e këtyre të dhënave nëse ato janë përpunuar në kundërshtim më dispozitat e ligjit vendas, të cilat bëjnë të efektshme parimet themelore të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të kësaj Konvente;

e) e një mjeti ligjor mbrojtjeje nëse nuk është përmbushur një kërkese për konfirmim ose, sipas rastit, për komunikim, korrigjim ose fshirje të parashikuara në paragrafët b dhe c të këtij neni.

Neni 9
Përjashtimet dhe kufizimet

1. Nuk lejohet asnjë përjashtim për dispozitat e neneve 5, 6 dhe 8 të kësaj Konvente, përveç kur behet brenda kufijve të përcaktuar në këtë nen.

2. Devijimi nga dispozitat e neneve 5, 6 dhe 8 të kësaj Konventë lejoh et vetëm kur një devijim i tillë është i parashikuar nga ligji i palës dhe përben një mase të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes:

a) të mbrojtjes së sigurisë së shtetit, sigurisë publike, dhe interesave monetare të sheth ose të luftës kundër veprave penale;

b) të mbrojtjes së subjektit të të dhënave ose të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

3. Kufizimet në ushtrimin e të drejtave të parashikuara në nenin 8 paragrafi b, c dhe d, mund të parashikohen më ligj në lidhje më dosjet e të dhënave personale të automatizuara që përdoren për qëllime statistikore ose për kërkime shkencore kur duket së nuk ka ndonjë rrezik për cenimin e jetës privatë të subjekteve të të dhënave.

Neni 10
Sanksionet dhe mjetet e mbrojtjes

Çdo palë merr përsipër të caktoje sanksione të përshtatshme dhe mjete mbrojtjeje për shkeljen e dispozitave të ligjit të brendshëm, duke bërë të efektshme parimet themelore për mbrojtjen e të dhënave të parashikuara në këtë kapitull.

Neni 11
Mbrojtja e gjere

Asnjë nga dispozitat e këtij kapitulli nuk interpretohet si për të kufizuar ose për të ndikuar në ndonjë mënyrë tjetër mundësinë e një palë për t'u siguruar subjekteve të te dhënave një masë më të gjerë së ajo e parashikuar në këtë Konvente.

KAPITULLI III
FLUKSI NDERKUFITAR I TË DHENAVE

Neni 12
Fluksi ndërkufitar i të dhënave personale dhe ligji i brendshëm

1. Dispozitat e mëposhtme zbatohen për transferimin përtej kufijve shtetërore, më çfarëdolloj mjeti, i të dhënave personale që i nënshtrohen përpunimit të automatizuar, ose që mblidhen më qëllimin e përpunimit të tyre në mënyrë të automatizuar.

2. Për qëllimin e vetëm të mbrojtjes së jetës private, një palë nuk e ndalon ose kushtëzon më autorizim të veçante flukset ndërkufitare të te dhënave personale që shkojnë në territorin e një palë tjetër.

3. Megjithatë, secila palë ka të drejtën e shmangies nga dispozitat e paragrafit 2:

a) nëse legjislacioni i saj përfshin rregulla specifike të kategorive të caktuara të te dhënave personale ose të dosjeve më të dhëna personale të automatizuara, për shkak të natyrës së këtyre të dhënave ose dosjeve, përveç kur rregullat e palës tjetër sigurojnë një mbrojtje identike;

b) kur transferimi behet nga territori i saj në territorin e një shteti joanetar, nëpërmjet ndërmjetësimit të territorit të një palë tjetër, më qellim që të evitohen të tilla transferime që rezultojnë në anashkalimin e legjislacionit të palës së përmendur në fillim të këtij kapitulli.

KAPITULLI IV
NDIHMA E NDERSJELLE

Neni 13
Bashkëpunimi ndërmjet palëve

1. Palët bien dakord t'i japin njëra-tjetrës ndihme të ndërsjelle, më qellim që të zbatohet kjo Konvente.

2. Për këtë qellim:

a) Çdo palë cakton një ose disa organe, emrin dhe adresën e të cilave ia komunikon Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës;

b) Çdo palë që ka caktuar më shume së një organ në komunikatën e saj që përmendet ne nënparagrafin e mësipërm kompetencën e secilit organ.

3. Një organ i caktuar nga një palë , më kërkese të një organi të caktuar nga një palë tjetër:

a) jep informacion në lidhje më ligjin e saj dhe praktikën administrative në fushën e mbrojtjes së të dhënave;

b) në pajtim më ligjin e brendshëm dhe për qëllimin e vetëm të mbrojtjes së jetës private, merr të gjitha masat për dhënien e informacionit faktik në lidhje më përpunimin specifik të automatizuar në territorin e saj, më përjashtim të te dhënave që janë në përpunim e sipër.

Neni 14
Ndihma për subjektet e të dhënave më banim jashtë shtetit

1. Secila palë ndihmon çdo person me banim jashtë shtetit për të ushtruar të drejtat e siguruara nga ligji i brendshëm, duke bërë të efektshme parimet e parashikuara në nenin 8 të kësaj Konvente.

2. Kur një person i tillë është me banim në territorin e një palë tjetër, atij i jepet mundësia

e paraqitjes së kërkesës më ndërmjetësimin e organit të caktuar nga ajo palë .

3. Kërkesa për ndihme përmban të gjitha hollësitë e nevojshme, duke shënuar ndërmjet të tjerash:

a) emrin, adresën dhe çdo të dhënë tjetër përkatëse, që identifikon personin që bën kërkesën;

b) dosjen e të dhënave personale të automatizuara për të cilën behet fjale në kërkese, ose kontrolluesin e saj;

c) qëllimin e kërkesës.

Neni 15

Garancitë në lidhje më asistencën e dhënë nga organet e caktuara

1. Një organ i caktuar nga një palë, i cili ka mane një informacion nga një organ i caktuar nga një palë tjetër që shoqëron një kërkese për ndihme ose në përgjigje të kërkesës së tij për ndihme, nuk e përdor këtë informacion për qëllime të tjera nga ato të përcaktuara në kërkesën për ndihme.

2. Çdo palë bën kujdes që personat që i përkasin ose veprojnë në emër të organit të emëruar t'u nënshtrohen detyrimeve të përshtatshme të fshehtësisë ose konfidencialitetit në lidhje më këtë informacion.

3. në asnjë rast, organi i caktuar nuk mund të beje kërkese për ndihme në pajtim më nenin 14 paragrafi 2, në emër të një subjekti të dhënash më banim jashtë shtetit, pa iu bërë kërkese dhe pa pëlqimin e dhënë shprehimisht nga personi i interesuar.

Neni 16

Refuzimi i kërkesës për ndihme

Organi i caktuar të cilit i është drejtuar një kërkese për ndihme, sipas neneve 13 dhe 14 te kësaj Konvente nuk mund ta refuzoje, përveç kur:

a) kërkesa nuk përputhet më kompetencën e organeve përgjegjëse për kthimin e përgjigjes në fushën e mbrojtjes së të dhënave;

b) kërkesa nuk përputhet më dispozitat e kësaj Konvente;

c. përmbushja e kërkesës do të ishte në kundërshtim më sovranitetin, sigurinë ose rendin publik të palës nga e cila është bërë emërimi, ose më të drejtat dhe liritë themelore të personave nen juridiksionin e asaj palë .

Neni 17

Shpenzimet dhe procedurat e ndihmës

1. Ndihma e ndërsjelle që palët i japin njëra-tjetrës sipas nenit 13 dhe ndihma që ata u japin subjekteve të te dhënave jashtë shtetit sipas nenit 14 nuk duhet të shkaktoje pagesën e asnjë shpenzimi ose tarifash, përveç atyre për ekspertet dhe përkthyesit. Këto shpenzime dhe tarifa përballohen nga pala që ka caktuar organi që bën kërkesën për ndihme.

2. Subjektit të te dhënave nuk mund t'i ngarkohen shpenzime dhe tarifa në lidhje më hapat e marra në emër të tij në territorin e një palë tjetër, përveç atyre që paguhen ligjërisht nga personat më banim në atë palë .

3. Detajet e tjera në lidhje me ndihmën mbi format dhe procedurat dhe gjuhet që duhen të përdoren përcaktohen drejtpërdrejt ndërmjet palëve të interesuara.

KAPITULLI V
KOMITETI KONSULTATIV

Neni 18

Përbërja e komitetit

1. Një komitet konsultativ krijohet pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

2. Çdo palë cakton një përfaqësues në komitet dhe një zëvendës përfaqësues.

Çdo shtet anëtar i Këshillit të Europës, që nuk është palë në këtë Konvente, ka të drejtën e përfaqësimit në komitet më ane të një vëzhguesi.

3. më vendim unanim, Komiteti Konsultativ mund të ftoje çdo shtet joanetar të Këshillit të Europës që nuk është palë në Konvente për t'u përfaqësuar më një përfaqësues në një mbledhje të caktuar.

Neni 19
Funksionet e Komitetit

Komiteti Konsultativ:

a) mund të beje propozime në lidhje më lehtësimin ose përmirësimin e zbatimit te Konventës;

b) mund të beje propozime për përmirësimin e kësaj Konvente në pajtim më nenin 21;

c) formulon mendimin e tij për çdo propozim për përmirësimin e kësaj Konvente që i është paraqitur në pajtim më nenin 21 paragrafi 3;

d) më kërkese të një palë, mund të shprehe mendimin e tij për çdo çështje që ka të beje me zbatimin e kësaj Konvente.

Neni 20
Procedura

1. Komiteti Konsultativ thirret nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës. Mbledhja e tij e pare mbahet brenda 12 muajve që nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente, pastaj ai mblidhet të paktën një here në dy vjet dhe për çdo rast kur një e treta e përfaqësuesve të palëve kërkojnë thirrjen e tij.

2. Një shumice e përfaqësuesve të palëve përben numrin e nevojshëm për një mbledhje te Komitetit Konsultativ.

3. Pas çdo mbledhje, Komiteti Konsultativ i paraqet Komitetit të Ministrave të Këshillit te Europës një raport mbi punën e tij dhe mbi funksionin e Konventës.

4. në baze të dispozitave të kësaj Konvente, Komiteti Konsultativ përpilon rregullat e veta procedurale.

KAPITULL VI
NDRYSHIMET

Neni 21
Ndryshimet

1. Ndryshimet e kësaj Konvente mund të propozohen nga një palë , Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës ose Komiteti Konsultativ.

2. Çdo propozim për ndryshim u komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit te Europës shteteve anëtarë të Këshillit të Europës dhe shteteve joanetare që janë anëtarësuar ose janë ftuar të anëtarësohen në këtë Konvente në pajtim më dispozitat e nenit 23.

3. Për më tepër, çdo ndryshim, i propozuar nga një palë ose Komiteti i Ministrave, i komunikohet Komitetit Konsultativ i cili i paraqet Komitetit të Ministrave mendimin e tij për ndryshimin e propozuar.

4. Komiteti i Ministrave shqyrton ndryshimin e propozuar dhe çdo mendim të paraqitur nga Komiteti Konsultativ dhe mund të aprovoje ndryshimin.

5. Teksti i çdo ndryshimi, i aprovuar nga Komiteti i Ministrave në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, u paraqitet palëve për pranim.

6. Çdo ndryshim i aprovuar në pajtim më paragrafin 4 të këtij neni, hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pasi të gjitha palët të kenë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e tij.

KAPITULLI VII
DISPOZITAT PERFUNDIMTARE

Neni 22
Hyrja në fuqi

1. Kjo Konvente është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtarë të Këshillit të Europës; ajo i nënshtrohet, ratifikimit, pranimit ose aprovimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit depozitohen të Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

2. Kjo Konvente hyn në fuqi në ditën e pare të muajit pas kalimit të një afati tre mujor pas datës në të cilën pese shtete anëtarë të Këshillit të Europës të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t'iu nënshtruar konventës në pajtim më dispozitat e paragrafit të mësipërm.

3. në lidhje me çdo shtet që e shpreh pëlqimin e tij më vonë për t'iu nënshtruar Konventës, kjo hyn në fuq"i në ditën e pare të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose aprovimit.

Neni 23
Anëtarësimi nga shtetet joanetare

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës mund të ftoje çdo shtet që nuk është anëtar i Këshillit të Europës të anëtarësohet në këtë Konvente nëpërmjet një vendimi të marre më shumicën e parashikuar në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Europës dhe më votën unanime të përfaqësuesve të shteteve kontraktuese që kane të drejtën e përfaqësimit në komitet.

2. në lidhje më çdo shtet që anëtarësohet, Konventa hyn në fuqi në ditën e pare të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së depozitimit të instrumentit të anëtarësimit të Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 24
Dispozita territorial

1. Çdo shtet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit pranimit ose aprovimit ose anëtarësimit, mund të përcaktojë territorin ose pjesën e territorit në të cilën zbatohet kjo Konvente.

2. në një date të mëvonshme, çdo shtet, më ane të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund ta shtrije zbatimin e kësaj Konvente në çdo pjese tjetër territori të përcaktuar në deklarate. në lidhje më këtë pjese territori, Konventa hyn në fuqi në ditën e pare të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së marrjes së një deklarate të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklarate e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm, në lidhje më çdo pjese territori të përcaktuar në këtë deklarate, mund të tërhiqet më ane të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja hyn në fuqi në ditën e pare të muajit pas kalimit të një afati prej gjashte muajsh pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 25
Rezervat

Asnjë rezerve nuk mund të behet në lidhje më dispozitat e kësaj Konvente.

Neni 26
Denoncimi

1. Çdo palë mund të denoncoje në do moment këtë Konvente nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Një denoncim i tillë hyn në fuqi në ditën e pare të muajit pas kalimit të një periudhe prej gjashte muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 27
Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtarë të Këshillit të Europës dhe do shtet që është anëtarësuar në këtë Konvente për:

a) çdo nënshkrim;

b) depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose anëtarësimit;

c) çdo date të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në pajtim më nenet 22, 23 dhe 24;

d) çdo akt, njoftimi ose komunikimi tjetër që ka të beje më Konventën.

Si dëshmi, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, e kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Strasburg, më 28 janar 1981, në anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet janë njësoj autentike, në një kopje të vetme, e cila mbetet e depozituar në arkivat e Këshillit të Europës.

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës u transmeton kopje të vërtetuara të gjitha shteteve anëtarë të Këshillit të Europës, Komunitetit Evropian dhe çdo shteti tjetër të ftuar për t'u anëtarësuar në Konventë.